



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 38, datë 22.04.2022

PËR

AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT 2 VJEÇAR, ME KARAKTER
PROFESIONAL NË "AGROBIZNES" ME PROFILE "MARKETING I PRODUKTIT
BUJQËSOR" DHE "MENAXHIM I FERMËS BUJQËSORE", TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR "LOGOS"

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, "Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 "Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit", në mbledhjen e tij të datës 22.04.2022, në kuadër të vendimmartjes për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar, me karakter profesional në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore", me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Program studimi 2 vjeçar me karakter profesional në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore"
- b) Cikli i studimit: Program me karakter profesional
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 405, datë 25.07.2019
- d) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar "Logos"
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Menaxhimit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite/4 semestra
- g) Kredite (ECTS): 120 kredite

- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Logos”
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 5

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit me karakter profesional”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:

1. Përmbajtja e lëndëve të planit mësimor të këtij programi studimi, nuk është në përputhje me ciklin e studimit të këtij programi studimi.
2. Mungesa në planin mësimor, e lëndëve të marketingut, bie ndesh me objektivat dhe rezultatet e pritshme të të nxënës, që ky program studimi synon.
3. Në lëndët e lidhura me profilin e Menaxhimit të Fermës Bujqësore, nuk studiohen produktet kryesore të bujqësisë shqiptare, siç janë, bimët aromatike e mjekësore, perimet e serave dhe blegtoaria, si rrjedhojë nuk pasqyrohet realiteti dhe vizioni i bujqësisë shqiptare.
4. Në syllabuset e këtij programi studimi nuk përfshihet dosja praktike e studentëve, si dhe kompetencat e fituara nga studentët gjatë praktikës.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit 2 vjeçar me karakter profesional në “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore”, të Kolegjit Universitar “Logos”, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **21/04/2025**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 38, datë 22.04.2022, “Për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesional në “Agrobiznes” me profile “Marketing i Produktit Bujqësor” dhe “Menaxhim i Fermës Bujqësore”, të Kolegjit Universitar “Logos”, janë si vijon:

1. Institucioni, të rishikojë përmbajtjen e lëndëve të planit mësimor të këtij programi studimi, me qëllim përshtatjen e njohurive të tyre, me ciklin e studimit të këtij programi studimi.
2. Institucioni, të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit, lëndë të marketingut, me qëllim arritjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, që ky program studimi synon.
3. Institucioni, të rishikojë përmbajtjen e lëndëve të lidhura me profilin e Menaxhimit të Fermës Bujqësore, me qëllim përfshirjen në to e temave që lidhen me produktet kryesore të bujqësisë shqiptare, siç janë, bimët aromatike e mjekësore, perimet e serave dhe blegtoria.
4. Institucioni, të rishikojë syllabuset e këtij programi studimi, me qëllim përfshirjen në to të dosjes praktike të studentëve, si dhe kompetencat e fituara nga studentët gjatë praktikës.
5. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi, me qëllim që raporti teori / praktikë, të jetë në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
6. Institucioni, të pasurojë e përditësojë fondin e literaturës së bibliotekës me botime të viteve të fundit, në funksion të këtij programi studimi.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “Logos”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

